

Ligji 112/2021 datë 25.11.2021

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:
Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 11 shtohen pikat 12 deri 16 me këtë përmbajtje:

“12. Taksë për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur, të përfshirë në kodet 0402 10 19 dhe 0402 21 18 të NKM-së.

13. Taksë për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara, të përfshirë në kodet 0404 90 21, 0404 90 23 dhe 0404 90 29 të NKM-së.

14. Taksë për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit, të përfshirë në kreun 0404 10 të NKM-së.

15. Taksë për importimin dhe prodhimin e krem qumështit, të përfshirë në kreun 0402 të NKM-së.

16. Taksë për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare.”.

Neni 2

Në nenin 4, pas pikës 11 shtohen pikat 12 deri 16 me këtë përmbajtje:

“12. Taksa për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur është në vlerën 100 lekë/kg.

13. Taksa për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara është në vlerën 16 lekë/litër.

14. Taksa për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit është në vlerën 150 lekë/ litër.

15. Taksa për importimin dhe prodhimin e krem qumështit është në vlerën 150 lekë/litër.

16. Taksa për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare, është në vlerën 40 lekë/litri.”.

Neni 3

Në nenin 5, pas shkronjës “gj” shtohen shkronjat “h” deri në “l” me këtë përmbajtje:

“h) për taksën e importimit dhe prodhimit të qumështit pluhur, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

i) për taksën e importimit dhe prodhimit për pijet e homogjenizuara, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

j) për taksën e importimit dhe prodhimit për hurrën e qumështit, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

k) për taksën e importimit dhe prodhimit për krem qumështin, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

l) për taksën për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare, organet doganore.”.

Neni 4

Në nenin 9, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Përfshihen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hurrë qumështi dhe taksës për krem qumështi, fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat në etiketën e miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kanë të evidentuar sasinë në përqindje të këtyre produkteve që janë trupëzuar në produktin përfundimtar. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit sipas kësaj pike përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për kontrollin ushqimor.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E
Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën 25.11.2021

Botuar ne F.Zyrtare 197/2021

Dale nga shtypi me 21.12.2021